# PYETJE TË BËRA SHPESH PËR USHQIMIN FALAS DHE ME ÇMIM TË REDUKTUAR NË SHKOLLË 2023-24

I nderuar prind/kujdestar:

Fëmijët kanë nevojë për ushqime të shëndetshme që të mësojnë. **Qarku i Hapsirës Shkollore i Stoughtonit** ofron ushqime të shëndetshme çdo ditë në shkollë.

| | Mëngjesi | Dreka |
|---|---|---|
| Elementarët | $1.70 | $3.10 |
| Shkollat E Ulta | $1.95 | $3.25 |
| Shkolla e Mesme | $1.95 | $3.35 |
| qumësht | $ .50 | $. 50 |

Çmimi i reduktuar është **$.30** për mëngjesin dhe **$.40** për drekën. Kjo paketë përfshin një aplikacion për aplikim për ushqim falas ose me çmim të reduktuar, dhe udhëzimet e detajuara për plotësimin e tij. Më poshtë janë disa pyetje të zakonshme dhe përgjigje për t'ju ndihmuar me procesin e aplikimit.

1. KUSH MUND TË MARRË USHQIM FALAS OSE ME ÇMIM TË REDUKTUAR?
   - Të gjithë fëmijët në familjet që marrin përfitime nga programet FoodShare, Food Distribution Program on Indian Reserves (FDPIR), oseW-2 Cash Benefits kanë të drejtë për ushqime falas.
   - Fëmijët e birësuar që janë nën përgjegjësinë ligjore të një agjencie për kujdesin e të birësuarve, ose të një gjykate, kanë të drejtën për ushqime falas.
   - Fëmijët që marrin pjesë në programin (Head Start) të shkollës së tyre kanë të drejtë për ushqime falas.
   - Fëmijët që plotësojnë kriteret e të qenit të pastrehë, të larguar nga shtëpia ose emigrantë, kanë të drejtën për ushqime falas.
   - Fëmijët mund të marrin ushqime falas ose me çmim të reduktuar nëse të ardhurat e familjes tuaj janë brenda limiteve në Udhëzimet Federale të Pranueshmërisë për të Ardhurat. Fëmijët tuaj mund të kualifikohen për ushqime falas ose me çmim të reduktuar nëse të ardhurat e familjes tuaj bien në ose nën limitet në këtë tabelë.

| Udhëzimet Federale të Pranueshmërisë për të Ardhurat për Vitin Shkollor 2021-22 | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i pjesëtarëve të familjes | Çdo vit ($) | Çdo muaj ($) | Çdo javë ($) |
| 1 | 26,973 | 2,248 | 519 |
| 2 | 36,482 | 3,041 | 702 |
| 3 | 45,991 | 3,833 | 885 |
| 4 | 55,500 | 4,625 | 1,068 |
| 5 | 65,009 | 5,418 | 1,251 |
| 6 | 74,518 | 6,210 | 1,434 |
| 7 | 84,027 | 7,003 | 1,616 |
| 8 | 93,536 | 7,795 | 1,799 |
| Çdo person tjetër shtesë: | 9,509 | 793 | 183 |

2. SI MUND TA DI NËSE FËMIJËT E MI KUALIFIKOHEN SI TË PASTREHË, EMIGRANTË APO TË LARGUAR NGA SHTËPIA? A u mungon pjesëtarëve të familjes tuaj një adresë e përhershme? A jeni duke qëndruar së bashku në një strehë, hotel apo në një shtëpi tjetër për strehim të përkohshëm? A zhvendoset familja juaj nga një vend në një tjetër në çdo sezon? A ka fëmijë që jetojnë me ju të cilët kanë zgjedhur të largohen nga familja ose banesa e tyre e mëparshme? Nëse besoni që fëmijët në familjen tuaj i përmbushin këto përshkrime, dhe nuk ju është thënë se fëmijët mund të marrin ushqime falas, ju lutemi telefononi ose dërgoni email në **Keli Melcher, Direktore e Shërbimeve Studentore 608.877.5041 ose Keli.Melcher@Stoughton.k12.wi.us.**

3. A DUHET TË PLOTËSOJ NJË APLIKACION PËR SECILIN FËMIJË? Jo. *Përdorni një Aplikacion për Ushqim Falas dhe me Çmim të Reduktuar në Shkollë, për të gjithë studentët në familjen tuaj.* Ne nuk mund ta aprovojmë një aplikim që nuk është i plotë, prandaj sigurohuni që të plotësoni të gjitha informacionet që duhen. Kthejeni aplikacionin e plotësuar tek: **Melanie Monnot tek 1920 Lincoln Ave, Stoughton WI 53589 ose melanie.monnot@Stoughton.k12.wi.us.**

4. A DUHET TA PLOTËSOJ NJË APLIKACION NËSE KAM MARRË NJË LETËR GJATË KËTIJ VITI SHKOLLOR QË THOTË SE FËMIJËT E MI TASHMË JANË APROVUAR PËR USHQIME FALAS? Jo, por ju lutemi lexojeni me kujdes letrën që keni marrë dhe ndiqni udhëzimet në të. Nëse mungon ndonjë prej fëmijëve tuaj në njoftimin për pranimin e ushqimit falas, kontaktoni **Jenny McKenna në 608.877.5012**.

5. A MË DUHET MUA QË TË PLOTËSOJ NJË APLIKACION NËSE FËMIU IM MERR PJESË NË SHKOLLËN E PROVISIONUAR PËR KOMUNITETIN SIPAS KRITEREVE TË PRANIMIT (CEP)? Nëse fëmiu juaj shkon në një shkollë që merr pjesë në CEP, përfitimet për mëngjes dhe drekë pa pagesë nuk varet nga kthimi i këtij aplikacioni. Megjithatë, ky informacion është i nevojshëm për programet e tjera dhe mund të përdoret për të përcaktuar nëse familja juaj i përmbush kushtet për përfitime shtesë.

6. A MUND TË APLIKOJ ONLINE? Po! Nxiteni të plotësoni një aplikim online në vend të aplikimit në letër, nëse keni mundësi. Aplikimi online ka të njëjtat kërkesa dhe do t'ju kërkojë të njëjtat informacione si aplikimi në letër. Vizitoni **www.Stoughton.k12.wi.us /Our District/ Departments / Food Service** për të filluar ose për të mësuar më shumë rreth procesit të aplikimit online. Kontaktoni **Melanie Monnot tek 1920 Lincoln Ave, Stoughton WI 53589 ose melanie.monnot@Stoughton.k12.wi.us** nëse keni pyetje rreth aplikimit online.

7. APLIKACIONI I FËMIJËS TIM ISHTE APROVUAR VITIN E KALUAR. A DUHET TË PLOTËSOJ NJË APLIKACION TË RI? Po, Aplikacioni i fëmijës tuaj është i vlefshëm vetëm për një vit shkollor, dhe vetëm për disa ditë të vitit të ri shkollorë, deri me datën 10/14/19 ose kur përcaktohet një vendim i ri. Ju duhet të dërgoni një aplikacion të ri përveq nëse shkolla ju ka lajmëruar juve se fëmiu juaj ka të drejtë për ushqim falas për vitin e ri shkollor. Nëse nuk paraqisni një aplikacion të ri që është aprovuar nga shkolla ose nuk ju ka thënë shkolla se fëmiu juaj ka të drejtë për ushqim falas në vitin e ri shkollor. Fëmiu juaj do të duhet të paguaj qmimin e plotë për ushqimite.

8. UNË MARR GJËRA NGA PROGRAMI "WIC." A MUND TË MARRIN FËMIJËT E MI USHQIMIN FALAS? Fëmijët në familje që marrin pjesë në WIC <u>mund</u> të pranohen për ushqime falas ose me çmim të reduktuar. Ju lutem dërgoni një aplikacion.

9. FËMIU IM KUALIFIKON PËR PROGRAMET BADGERCARE PLUS OSE MEDICAID. A MUND TË MARRIN FËMIJËT E MI USHQIM FALAS? Fëmijët me inshurencat BadgerCare Plus, Medicaid, ose sigurime shtetrore <u>mund</u> të kenë të drejtë për ushqim falas ose me qmim të reduktuar, por bazohet në të ardhurat familjare dhe sasin e të ardhurave. Ju lutemi dërgoni një aplikacion të vendosim nëse familja juaj kualifikon për ushqim falas.

10. A DO TË KONTROLLOHEN INFORMACIONET QË UNË I JAP? Po. Gjithashtu mund t'ju kërkojmë të dërgoni një vërtetim me shkrim për të ardhurat familjare që ju i raportoni.

11. NËSE UNË NUK KUALIFIKOJ, A MUND TË APLIKOJ MË VONË? Po, Ju mund të aplikoni në qdo kohë gjatë vitit shkollor. Për shembull, fëmijët që prindërit ose personat përgjegjës të cilët humbin punën ose kanë vështirësi me financat mund të kenë të drejtë për ushqim falas ose me qmim të reduktuar nëse të ardhurat familjare ulen nën limitin e të ardhurave.

12. ÇKA NËSE NUK JAM DAKORD ME VENDIMIN PËR APLIKACIONIN TIM? Ju duhet të flisni me punonjësit e shkollës. Gjithashtu mund të kërkoni një seancë gjyqësore duke telefonuar ose duke i shkruar: **Erica J. Pickett, Direktore e Shërbimeve të Biznesit në 320 North Street, Stoughton, WI 53589 ose 608.877.5012 ose** Erica.Pickett@Stoughton.k12.wi.us.

13. A MUND TË APLIKOJ NËSE DIKUSH NË FAMILJEN TIME NUK ËSHTË SHTETAS I SHBA? Po. Ju, fëmijët tuaj ose pjesëtarët e tjerë të familjes nuk ka nevojë që të jenë shtetas të SHBA për të aplikuar për ushqim falas ose me çmim të reduktuar.

14. ÇKA NËSE TË ARDHURAT E MIA NUK JANË GJITHMONË TË NJËJTA? Shënoni shumën që merrni <u>normalisht</u>. Për shembull, nëse normalisht merrni $1000 në muaj, por keni humbur disa prej ditëve të punës muajin e kaluar dhe keni marr vetëm $900, shkruani që bëni $1000 në muaj. Nëse gjithnjë punoni pas orarit të punës, përfshijeni ato të ardhura, por mos e përfshini nëse punoni jashtë orarit vetëm për ndonjë raste. Nëse keni humbur punën apo nëse ju janë reduktuar orët apo pagat, përdorni të ardhurat që keni aktualisht.

15. ÇKA NËSE NDONJË PJESËTAR I FAMILJES NUK KA TË ARDHURA PËR TË RAPORTUAR? Pjesëtarët e familjes mund të mos marrin disa lloje të të ardhurave që ju kërkojmë të raportoni në aplikacion, ose mund të mos keni të ardhura fare. Kur ndodh kjo, ju lutem shënoni 0 në atë fushë. Sidoqoftë, nëse vendet ku tregohen të ardhurat lihen të paplotësuara ose bosh, ato do të llogariten <u>gjithashtu</u> si zero. Ju lutemi keni kujdesë kur lini vendet e të ardhurave bosh pasi që ne do të <u>supozojmë</u> se ju i keni lënë ato qëllimisht.

16. NE JEMI NË SHËRBIMET USHTARAKE, A I RAPORTOJMË TË ARDHURAT TONA NDRYSHE? Pagesa juaj e rregullt dhe parat bonus duhet të raportohen si të ardhura. Nëse merrni para për strehim jashtë bazës, ushqime ose rroba ato duhet të përfshihen si të ardhura. Sidoqoftë, nëse strehimi juaj është pjesë e Nismës të Privatizimit të Strehimit Ushtarak, mos e përfshini strehimin si të ardhura. Mos përfshini asnjë pagesë lufte që rezulton nga ndrrimi i vendit ose "dislokimi", si e ardhur.

17. ÇKA NËSE NUK KA HAPËSIRË TË MJAFTUESHME NË APLIKACION PËR TË GJITHË FAMILJEN TIME? Shënoni çdo pjesëtar tjetër të familjes në një fletë tjetër dhe bashkëngjiteni në aplikacionin tuaj. Kontaktoni **Melanie Monnot në 608.877.5419 ose vizitoni zyrën e shkollës tuaj ose faqen e internetit të shkollës** për të marrë një aplikacion të dytë.

18. FAMILJA IME KA NEVOJË PËR MË SHUMË NDIHMË. A KA PROGRAME TË TJERA PËR TË CILAT MUND TË APLIKOJ? Për të mësuar më shumë se si të aplikoni për FoodShare apo përfitime të tjera ndihmëse, kontaktoni me zyrën vendase për ndihmë ose telefononi 1-800-362-3002.

Nëse keni pyetje ose ju duhet ndihmë, telefononi **Melanie Monnot në 608.877.5419**.

Me Sinqeritet, Erica J. Pickett, Direktore e Shërbimeve të Biznesit

# SI TË APLIKONI PËR USHQIM PA PAGESË DHE PËR ULJE TË ÇMIMEVE TË USHQIMIT TË SHKOLLËS

Ju lutem përdorni këto udhëzime për t'ju ndihmuar që të plotësoni aplikimin për çmimin e ushqimit të shkollës pa pagesë ose me çmim të reduktuar. Ju duhet të dorëzoni vetëm një aplikacion për pjestarët e familjes edhe nëse fëmijët tuaj shkojnë në shkolla të ndryshme në **Qarkun e Hapsirës Shkollore të Stoughtonit**. Aplikacioni juaj duhet të plotësohet tërësisht për të vërtetuar fëmijët tuaj për ushqime me falas dhe me çmime të reduktuara. Ju lutem ti ndiqni me rregull këto udhëzime. Nëse në çdo kohë ju nuk jeni të sigurt se çfarë duhet të bëni tjetër, ju lutem kontaktoni **Melanie Monnot, 608.877.5419 melanie.monnot@Stoughton.k12.wi.us.**

**JU LUTEM PËRDORNI NJË STILOLAPS (JO NJË LAPËS) KUR TË PLOTËSONI APLIKACIONIN DHE MUNDOHUNI TË SHKRUANI SA MË QARTË.**

## HAPI 1: SHËNONI TË GJITHË PJESËTARËT E FAMILJES QË JANË TË MITUR, FËMIJË, DHE STUDENTË DERI MË DHE DUKE PËRFSHIRË KLASËN E 12

Na tregoni sesa të mitur, fëmijë dhe student shkolle jetojnë në familjen tuaj. NUK është e nevojshme që ato të jënë të afërt me ju për të qënë pjesë e familjes tuaj.
**Kë duhet të shënoni këtu?** Kur të plotësoni këtë sektor, ju lutemi përfshini TË GJITHË pjesëtarët e familjes tuaj që janë:

- Fëmijë të moshës 18 vjeçare ose më poshtë DHE që janë të mbështetur nga të ardhurat e familjes;
- Nën kujdesin tuaj sipas një marrëveshjeje kujdestarie, ose kualifikim si të pastrehë, emigrant, ose të rinjë të arratisur, ose të regjistruar në programin Head Start; dhe
- Studentët që marrin pjesë në Qarkun e Hapsirës Shkollore të Stoughtonit pavarësisht nga mosha.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **A) Shënoni emrin e secilit fëmijë.** Shënoni emrin e secilit fëmijë. Përdorni një rresht të aplikacionit për secilin fëmijë. Kur ti shënoni emrat, shënoni çdo shkronjë në secilën katrorë. Ndaloni nëse nuk keni më hapësirë. Nëse në aplikacion ka më shumë fëmijë sesa rreshta, bashkangjisni një letër të dytë me të gjithë informacionin e nevojshëm për fëmijët shtesë. | **B) Shënoni klasën dhe emrin e shkollës që fëmiu merr pjesë ose shënoni 'asnjë' apo "n/a" nëse nuk është në shkollë.** Shënoni nivelin e klasës së studentit në kolonën e 'Klasës'. | **C) A keni ndonjë fëmijë të birësuar përkohësisht?** Nëse ndonjë fëmijë i shënuar është fëmijë i birësuar, shënoni katrorin "Fëmijë I Birësuar", ngjitur me emrat e fëmijëve. Nëse jeni duke aplikuar VETËM për fëmijët e birësuar, pasi të plotësoni **HAPIN 1**, shkoni tek **HAPI 4**. Fëmijët e birësuar që jetojnë me ju mund të llogariten si pjesëtar të familjes tuaj dhe mund të shënohen në aplikimin tuaj. Nëse jeni duke aplikuar për fëmijë të birësuar dhe të pa-birësuar, shkoni tek hapi 3. | **D) A ka fëmijë të pastrehë, emigrant, të arratisur ose të regjistruar në programin Head Start?** Nëse ju besoni që ndonjë nga fëmijët e shënuar në këtë sektor përmbush këto përshkrime, zgjidhni kutinë "I Pastrehë, Emigrant, I arratisur ose Head Start" ngjitur me emrin e fëmijës dhe plotësoni të gjitha hapat e aplikacionit. |

## HAPI 2: A MERR PJESË AKTUALISHT NDONJË NGA ANËTART E FAMILJES NË PROGRAMET FoodShare, Përfitimet W-2 OSE FDIR?

**Nëse dikush në familjen tuaj (duke ju përfshirë edhe juve) aktualisht merr pjesë në një ose më shumë nga programet ndihmës të shënuara më poshtë, fëmijët tuaj kanë të drejtën për ushqim të shkollës pa pagesë:**

- Programi Ndihmës Suplementar i Ushqimit (SNAP) ose FoodShare.
- Ndihma e Përkohshme për familjet në nevojë (TANF) ose përfitimet W-2.
- Programi i Shpërndarjes Ushqimore mbi Rezervimet Indiane (FDPIR).

| | |
|---|---|
| **A) Nëse asnjë nga familjarët tuaj nuk merr pjesë në ndonjë nga programet e shënuara më sipër:**<br>• Lini **HAPIN 2** pa plotësuar dhe shkoni tek **HAPI 3**. | **B) Nëse ndonjë nga familjarët tuaj merr pjesë në ndonjë nga programet e shënuara më sipër:**<br>• Shkruani numrin e rastit ose "case number" për FoodShare,përfitimet nga W-2 ose FDPIR. Ju duhet të jepni vetëm një numër të rastit ose "case number". Nëse ju merrni pjesë në ndonjë nga këto programe dhe nuk e dini numrin tuaj të rastit, ju lutemi kontaktoni agjentin tuaj të shërbimeve sociale. Ju lutemi vini re, se numëri i kartelës BadgerCare nuk është kualifikuese për ushqim falas në shkollë.<br>• Shkoni tek **HAPI 4**. |

## HAPI 3: RAPORTONI TË ARDHURAT PËR SECILIN ANËTAR TË FAMILJES

**Si mund ti raportoj të ardhurat e mia?**

- Përdorni listat e titulluara "**Burimet e të ardhurave për Fëmijë**" dhe "**Burimet e të ardhurave për të Rritur**", të shkruara në pjesën e pasme të aplikacionit, për të përcaktuar nëse familja juaj ka ndonjë të ardhur për të raportuar.
- Raportoni të gjitha shumat VETËM NË TË ARDHURAT BRUTO. Raportoni të gjitha të ardhurat vetëm në dollarë. Mos përfshini centin. Të ardhurat bruto janë të ardhurat totale të përfituara para taksave. Shumë njerëz i mendojnë të ardhurat si një shumë që ato "marrin në shtëpi" dhe jo si total të shumës "bruto". Sigurohuni që të ardhurat që ju raportoni në këtë aplikacion NUK kanë të reduktuar shumën që paguani për taksa, pagesat e sigurimit, ose çdo shumë tjetër të marrë nga paga juaj.

- Shkruani “0” në çdo fushë ku nuk ka asnjë të ardhur për të raportuar. Çdo fushë e të ardhurave e lënë bosh ose e paplotësuar, do të llogaritet gjithashtu si zero. Nëse ju shkruani ‘0’ ose lini çdo fushë të paplotësuar, ju jeni duke vërtetuar (premtuar) që nuk keni asnjë të ardhur për të raportuar. Nëse zyrtarët lokal dyshojnë që të ardhurat e familjes tuaj janë raportuar në mënyrë jo të saktë, aplikacioni juaj do të investigohet.
- Shënoni sesa shpesh mirret çdo lloj i të ardhurave duke përdorur katrorin në të djathtë të secilës fushë.

## 3.A. RAPORTONI TË ARDHURAT E FITUARA NGA FËMIJËT

**A) Raportoni të gjitha të ardhurat e fituara ose të marra nga fëmijët.** Raportoni kombinimin e të ardhurave bruto për të GJITHË fëmijët e shënuar në HAPIN 1 të familjes tuaj në katrorin e shënuar “Të ardhurat e fëmijës”. Llogarisni vetëm të ardhurat personale të fëmijës së birësuar përkohësisht nëse ju jeni duke aplikuar për ta bashkë me pjesën e familjes tuaj.

***Çfarë është e ardhura e fëmijës?*** E ardhura e fëmijës është shuma e marrë jashtë familjes tuaj që i paguhet DIREKT fëmijës tuaj. Shumë pjesëtarë të familjeve nuk kanë asnjë të ardhur të fëmijëve.

## 3.B. RAPORTONI TË ARDHURAT E FITUARA NGA TË RRITURIT

**Shënoni emrat e anëtarëve të rritur të familjes.**

- Shënoni emrin e secilit anëtar të familjes në katrorin e shënuar “Emrat e Anëtarëve të Rritur të Familjes (Emri dhe Mbiemri).” Ndërkohë që plotësoni këtë sektor, ju lutem përfshini TË GJITHË anëtarët e rritur të familjes tuaj që jetojnë më ju dhe që ndajnë të ardhurat dhe shpenzimet me ju, edhe nëse ato nuk janë familjarë të ngushtë me ju edhe nëse ato nuk kanë të ardhurat e veta.
- ***MOS përfshini:***
  - Njerëz që jetojnë me ju por që nuk mbështeten nga të ardhurat e familjes tuaj DHE nuk kontribojnë të ardhura në familjen tuaj.
  - Foshnjet, Fëmijët dhe studentët që i keni shënuar në **HAPIN 1**.

**C) Raportoni të ardhurat nga puna.** Raportoni të gjitha të ardhurat totale bruto “gross income” (para taksave) nga puna në fushën e aplikimit “Fitime nga Puna”. Këto janë zakonisht të ardhurat e marra nga punët. Nëse ju keni një biznes i vetë-punësuar ose një pronar ferme, ju do të raportoni të ardhurat tuaja neto “et income”.

***Po nëse unë jam i vetë-punësuar?*** Raportoni të ardhurat nga ajo punë si një shumë neto “net income”. Kjo është llogaritur duke zbritur shpenzimet totale operative të biznesit tuaj nga faturat bruto “gross” ose të ardhurat.

**D) Raportoni të ardhurat nga ndihmat publike/mbështetja e fëmijës/ushqimi “SSI / VA / Benefits”** të ardhurat/SSI/VA **.** Raportoni të gjitha të ardhurat që aplikohen në fushën e aplikimit “Ndihmat Publike/Mbështetje e Fëmijës/Ushqim”. Mos raportoni vlerën e parave të çdo përfitimi të ndihmës publike që NUK është shënuar në tabelë. Nëse të ardhurat janë fituar nga mbështetja e fëmijës ose ushqimi, raportoni vetëm pagesat e urdhërit të gjykatës. Pagesat informale por të rregullta duhet të raportohen si të ardhura “të tjera” në pjesën tjetër.

**E) Raportoni të ardhurat nga pensioni/dalja në pension/të gjitha të ardhurat e tjera.** Raportoni të gjitha të ardhurat që aplikohen në fushën e aplikimit “Pensioni/dalja në pension/Të Gjitha të Ardhurat Tjera”.

**F) Të ardhurat e ndryshueshme.** Për punonjësit sezonal dhe të tjerët, të ardhurat e të cilëve ndryshojnë dhe zakonisht fitojnë më shumë para në disa muaj në krahasim me muajt e tjerë. Në këto situata, projektoni normën vjetore të të ardhurave dhe raportojeni atë. Kjo përfshin punonjësit me kontrata punësimi vjetore por mund të zgjedhin që të kenë pagat e paguara për një periudhë të shkurtër kohe; për shembull, punonjësit e shkollës.

**G) Raportoni përmasën totale të familjes tuaj.** Shënoni numrin total të pjesëtarëve të familjes në fushën “Anëtarët total të familjes (Fëmijë dhe Të rritur).” Ky numër DUHET të jetë i barabartë me numrin e anëtarëve të familjes të përfshirë në **HAPIN 1** dhe **HAPIN 3**. Nëse ka ndonjë anëtar të familjes tuaj që ju nuk keni përfshirë në aplikacion, kthehuni dhe shtojeni ato. Është shumë e rëndësishme për të përfshirë të gjithë anëtarët e familjes, pasi përmasa e familjes tuaj ndikon në të drejtën tuaj për ushqim pa pagesë dhe për ushqimin me çmim të reduktuar.

**H) Jepni katër shifrat e fundit të Numrit tuaj të Sigurimit Shoqëror ose “Social Security Number” (SSN).** Një anëtar i rritur i familjes duhet të shënojë katër shifrat e fundit të SSN të tyre në hapësirën e caktuar. Ju keni të drejtë të aplikoni për përfitime edhe nëse ju nuk keni SSN. Nëse asnjë pjesëtar i familjes nuk ka SSN, lëreni këtë hapësire bosh dhe zgjidhni kutinë në të djathtë “Zgjidh nëse nuk ka SSN.”

## HAPI 4: INFORMACIONI I KONTAKTIT DHE NËNSHKRIMI I TË RRITURIT

***Një i rritur i familjes duhet të nënshkruaj formularin. Përmes nënshkrimit të aplikimit, anëtari i familjes është duke premtuar që i gjithë informacionet e dhëna janë të sakta dhe terësisht të raportuara. Përpara se të plotësoni këtë pjesë, ju lutem që gjithashtu të siguroheni që keni lexuar privatësinë dhe Deklaratat e të drejtave civile në anën e pasme e aplikimit.***

**A) Siguroni informacionin e kontaktit tuaj.** Shënoni adresën tuaj aktuale në fushat e siguruara nëse informacioni është i pranishëm. Nëse ju nuk keni një adresë të përhershme, kjo nuk i bën fëmijët tuaj që të mos kenë të drejtë për ushqim pa pagesë ose reduktim të çmimit të ushqimit të shkollës. Ndarja e numrit të telefonit, adresës së e-mailit ose e të dyjave është fakultative, por na ndihmon neve që t'ju kontaktojmë më shpejt nëse kemi nevojë që t'ju kontaktojmë.

**B) Shënoni dhe nënshkruani emrin tuaj.** Shënoni emrin e të rriturit që nënshkruan aplikacionin dhe që ai përson të nënshkruaj në katrorinë “Nënshkrimi i të rriturit.”

**C) Kthejeni formularin e kompletuar tek:**

**Melanie Monnot**
**1920 Lincoln Ave,**
**Stoughton, WI 53589**

**D) Ndani identitetin racor të fëmijës (ve) dhe etnicitetin (fakultative).** Në pjesën e pasme të aplikimit, ne ju pyesim që të ndani me ne informacionin rreth racës dhe etnicitetin e fëmijës suaj. Kjo fushë është fakultative dhe nuk ndikon në pranueshmërinë e fëmijës tuaj për ushqim pa pagesë ose reduktim të çmimit të ushqimit të shkollës.

# 2023-24 Aplikacioni për Ushqime Falas dhe me Çmim të Reduktuar në Shkollë

Plotësoni një aplikacion për familje. Ju lutem përdorni stilolaps (jo laps).

## HAPI 1 Shënoni të GJITHA foshnjet, fëmijët dhe studentët deri në dhe duke përfshirë ata të klasës së 12-të të cilët janë pjesëtarë të familjes.

(www.Stoughton.k12.wi.us /Our District/ Departments / Food Service

Përkufizimi i **Pjesëtar i familjes**: "Kushdo që jeton me ju dhe ndan të ardhurat dhe shpenzimet, edhe nëse nuk keni lidhje familjare."

| Emri i fëmiut | MI | Mbiemri i fëmiut | Klasa | Shkolla që shkon fëmiu ose 'NA' nëse nuk është në shkollë | Fëmijë i Birësuar | I pastrehë, Emigrant, I larguar nga shtëpia | Programet Head Start |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ☐ | ☐ | ☐ |
| | | | | | ☐ | ☐ | ☐ |
| | | | | | ☐ | ☐ | ☐ |
| | | | | | ☐ | ☐ | ☐ |
| | | | | | ☐ | ☐ | ☐ |

Shëno të gjitha ato që zbatohen.

## HAPI 2 A merr pjesë aktualisht ndonjë prej pjesëtarëve të familjes (përfshirë juve) në një ose më shumë prej programeve të asistencës në vazhdim: FoodShare, W-2 Cash Benefits, ose FDPIR?

Po / Jo

**Nëse i jeni përgjigjur JO** > Plotësoni HAPIN 3. **Nëse i jeni përgjigjur PO** > Shkruani numërin e rasitit këtu dhe pastaj shkoni në HAPIN 4 (Mos e plotësoni HAPIN 3)

**Numri i Rastit:** ____

Shkruani vetëm një numër të rastot në këtë hapësirë.

**Emri i Programit:** ____

BadgerCare nuk është i kualifikuar për ushqimet pa pagesë.

## HAPI 3 Raportoni të ardhurat për TË GJITHË pjesëtarët e familjes (Tejkalojeni këtë hap nëse i jeni përgjigjur 'PO' HAPIT 2)

### A. Të Ardhurat e Fëmijës/ve

Ndonjëherë fëmijët në familje fitojnë të ardhura. Ju lutemi përfshini TOTALIN e të ardhurave të fituara nga të gjitha foshnjat, fëmijët dhe studentët deri, dhe duke përfshirë ata të klasës së 12-të të të gjithë Pjesëtarëve të Familjes, të shënuar në HAPIN 1 këtu.

Të ardhurat e fëmijës/ve: $ ____

Sa shpesh? ○ Çdo javë ○ Çdo dy javë ○ 2x në muaj ○ Çdo muaj

### B. Të gjithë Pjesëtarët e Rritur të Familjes (përfshirë veten tuaj)

Shënoni të gjithë Pjesëtarët e Familjes që nuk janë të shënuar në HAPIN 1 (përfshirë veten tuaj) **edhe nëse nuk keni të ardhura.** Për çdo Anëtar Familjeje të shënuar, nëse ato marrin të ardhura, raportoni të ardhurat totale **bruto** (përpara taksave) për çdo burim, vetëm në dollarë (pa cent). Nëse nuk marrin të ardhura nga asnjë burim, shkruani '0'. Nëse vendosni '0' apo lini hapsirën bosh, atëherë po verifikoni (premtoni) se nuk ka të ardhura për të raportuar.

**F.** Punonjësit sezonalë, dhe të tjerët me pagesa të ndryshme, grumbulloni të ardhurat për gjithë vitin dhe raportoni këtu.

| Emri i Pjesëtarëve të Rritur të Familjes (Emri dhe Mbiemri) | C. Fitime nga puna | Sa shpesh? Çdo javë / Çdo dy javë / 2x në muaj / Çdo muaj | D. Asistenca publike/ Mbështetje për Fëmijët/ Ndihma Ushqimore/Përfitime SSI/VA | Sa shpesh? Çdo javë / Çdo dy javë / 2x në muaj / Çdo muaj | E. Pensionet/Pensioni nga puna/Sigurime Shoqërore, Të ardhura të tjera | Sa shpesh? Çdo javë / Çdo dy javë / 2x në muaj / Çdo muaj | F. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $____ |
| | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $____ |
| | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $____ |
| | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $____ |
| | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $ | ○ ○ ○ ○ | $____ |

**G. Numri total i Pjesëtarëve të Familjes (Fëmijë dhe të Rritur)** ____

**H. Katër shifrat e fundit të Numrit të Sigurimeve Shoqërore (SSN) të Personit me rrogën kryesore, ose një pjesëtari tjetër të rritur të familjes** X X X - X X - ____

**Shëno nëse nuk ka SSN** ☐

## HAPI 4 Informacionet e kontakti dhe nënshkrimi i të rriturve   Melanie Monnot, 1960 Lincoln Ave, Stoughton WI 53589

"Unë verifikoj (premtoj) se të gjitha informacionet në këtë aplikacion janë të sakta dhe se janë raportuar të gjitha të ardhurat. E kuptoj se këto informacione janë dhënë në lidhje me marrjen e fondeve Federale dhe se zyrtarët e shkollës mund t'i verifikojnë (kontrollojnë informacionet). Jam në dijeni se nëse jap qëllimisht informacione të gabuara, fëmijët e mi mund të humbasin përfitimet për ushqime, dhe unë mund të ndiqem penalisht sipas ligjeve Shtetërore dhe Federale në fuqi.

Adresa (nëse ka) ____ Apt # ____ Qyteti ____ Shteti ____ Kodi Zip ____ Telefoni gjatë ditës dhe emaili (me dëshirë) ____

Shtypni Emrin e të Rriturit që Plotëson këtë Formular ____ Nënshkrimi I të Rriturit që Plotëson këtë Formular ____ Data e Sotme *Muaji/Data/Viti* ____

## UDHËZIMET Burimet e të Ardhurave

**Burimet e të Ardhurave për Fëmijë**

| Burimet e të ardhurave të fëmijëve | Shembull (j) |
|---|---|
| - Fitimet nga puna “gross” | - Një fëmijë ka një punë të rregullt me orar të plotë apo të pjesëshëm ku ata fitojnë rrogën ose pagat |
| - Sigurimi social “Social Security”<br>- Pagesat e aftësisë së kufizuar<br>- Përfitimet e të mbijetuarve | - Një fëmijë është i verbër apo me aftësi të kufizuar dhe merr përfitimet e sigurimeve sociale<br>- Një prind me aftësi të kufizuar, në pension, ose i vdekur, dhe fëmiu i tyre merr përfitimet e sigurimeve sociale |
| - Të ardhurat nga personi jashtë familjes | - Nje mik apo një anëtar i zgjeruar i familjes i jep fëmijës rregullisht para për të shpenzuar |
| - Të ardhurat nga ndonjë burim tjetër | - Një fëmijë merr të ardhura të rregullta nga një fond pensioni privat, pensioni vjetor, ose ndihma |

**Burimet e të Ardhurave për të Rriturit**

| Fitimet nga puna | Ndihma Publike / Ushqimi / Mbështetja e fëmijës | Pensionet/Dalja në pension/Të gjitha të ardhurat e tjera |
|---|---|---|
| - Të ardhurat “Gross”, Rroga, pagat, bonuset me para<br>- Të ardhurat neto nga vetë-punësimi (ferma ose biznesi); **FERMA**-referohuni vizës 18 në formularin 1040 ose vizën 34 nga Orari F; **BIZNESI**-referohuni vizës 12 në formularin 1040 ose vizës 31 nga Orari C.<br>Nëse jeni në ushtrinë e SHBA-së:<br>- Pagesa bazë dhe bonuset me para (MOS përfshini pagën në rast lufte, FSSA ose kompensimet e strehimeve të privatizuara)<br>- Kompensimet për shtëpitë jashtë bazës ushtarake, ushqim dhe veshje | Përfitimet e papunësisë<br>- Kompensimi i punëtorëve<br>- Sigurimi i të Ardhurave Shtesë “Supplemental Security Income” (SSI)<br>- Ndihma me para nga Shteti ose qeveria lokale<br>- Pagesat për ushqimin<br>- Pagesat e mbështetjes së fëmijës<br>- Përfitimet e veteranëve<br>- Përfitimet e grevës | - Sigurimi social (duke përfshirë përfitimet nga fondi i pensionit të hekurudhave dhe “mushkërive të zeza”)<br>- Pensionet private ose përfitimet e aftësisë së kufizuar<br>- Të ardhurat e rregullta nga ndihmat apo pasuritë<br>- Pagesat periodike<br>- Të ardhurat nga investimet<br>- Interesi i fituar<br>- Të ardhurat nga qiraja<br>- Pagesat e rregullta me para nga personat jashtë familjes |

## OPSIONAL Identitetet Racor dhe Etnik i Fëmijëve

Na duhet që të kërkojmë informacione për racën dhe origjinën etnike të fëmiut tuaj. Këto informacione janë të rëndësishme dhe na ndihmojnë të sigurohemi që i shërbejmë plotësisht komunitetit tonë. Përgjigja në këtë pjesë është me dëshirë dhe nuk ndikon në të drejtën e pranimit të fëmijëve tuaj për ushqime falas ose me çmim të reduktuar në shkollë.

**Origjina etnike (zgjidh një):**

☐ Hispanik ose Latin

☐ Jo Hispanik ose Latin

**Raca (zgjidhni një ose më shumë):**

☐ I/e bardhë ☐ Indian Amerikan ose Vendas Alaske ☐ I zi ose Afrikano Amerikan

☐ Aziatik ☐ Vendas Hawaiian ose nga Tjetër Ishull Paqësor

**Akti Kombëtar i Drekës në Shkollë nga Richard B. Russell** i kërkon informacionet në këtë aplikacion. Ju nuk jeni të detyruar t'i jepni informacionet, por nëse nuk i jepni, ne nuk mund të aprovojmë fëmijën tuaj për ushqim falas, ose me çmim të reduktuar në shkollë. Ju duhet të përfshini katër shifrat e fundit të numrit të sigurimeve shoqërore “social Security” të pjesëtarit të rritur të familjes i cili nënshkruan formularin. Katër shifrat e fundit të numrit të sigurimeve shoqërore “social security” nuk kërkohen kur aplikoni në emër të një fëmije të birësuar ose nëse shënuar një program si Supplemental Nutrition Assistance Program (SNAP), Temporary Assistance for Needy Families Program (TANF), ose numër të rastit në Food Distribution Program on Indian Reservations (FDPIR) apo identifikues tjetër FDPIR për fëmiun tuaj, ose kur tregoni se pjesëtari i rritur i familjes që nënshkruan formularin nuk ka një numër të sigurimeve shoqërore “social security”. Ne do t'i përdorim informacionet tuaja për të përcaktuar nëse fëmiu juaj ka të drejtën për ushqime falas ose me çmim të reduktuar në shkollë, dhe për administrimin dhe zbatimin e programeve të drekës dhe mëngjesit. Ne MUND të ndajmë informacionet tuaja të pranimit me programet e edukimit, shëndetit dhe të ushqyerit për t'i ndihmuar ato që të vlerësojnë, financojnë ose përcaktojnë përfitimet për programet e tyre, auditorët për rishqyrtimin e programeve, dhe punonjësit e zbatimit të ligjit për t'i ndihmuar të shikojnë shkeljet e rregullave të programit.
Sipas ligjit Federal mbi të drejtat civile, dhe rregullave e rregulloreve të Departamentit Amerikan të Agrikulturës (USDA) mbi të drejtat civile, USDA-së, agjencive, zyrave, punonjësve dhe institucioneve të saj që marrin pjesë ose administrojnë programet e USDA nuk u lejohet të bëjnë diskriminime në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes kombëtare, seksit, paaftësive, moshës ose masave ndëshkimore apo dënimeve për aktivitete të mëparshme në të drejtat civile, në çfarëdo programi ose aktiviteti të drejtuar ose financuar nga USDA.

Personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për mjete të ndryshme komunikimi për informacione të programit (p.sh. Alfabeti Braile, shkronja të mëdha, audiokasetë, Gjuha Amerikane e Shenjaveo ose të Folurit me Gishtërinjë, etj.), duhet të kontaktojnë Agjencinë (të shtetit ose lokale) ku kanë aplikuar për të marrë përfitimet. Individët që janë të shurdhër, që kanë vështirësi në të dëgjuar ose në të folur, mund të kontaktojnë USDA përmes Federal Relay Service në (800) 877-8339. Për më tepër, informacionet e programit mund të vihen në dispozicion në gjuhë të tjera përveç anglishtes.

Për të bërë një ankesë të programit për diskriminim, plotësoni Formularin e Ankesës për Diskriminimin e Programit të USDA, (AD-3027) që mund të gjendet në faqen e internetit në: http://www.ascr.usda.gov/complaint_filing_cust.html, dhe në çdo zyrë të USDA, dhe shkruani në letër të gjitha informacionet e kërkuara në formular. Për të kërkuar një kopje të formularit të ankesës, telefononi (866) 632-9992. Paraqitni formularin e plotësuar ose letrën te USDA përmes:

(1) Postë: U.S. Department of Agriculture
Office of the Assistant Secretary for Civil Rights
1400 Independence Avenue, SW
Washington, D.C. 20250-9410;

(2) faksi: (202) 690-7442; ose

(3) e-maili: program.intake@usda.gov.

Institucioni është një ofrues i mundësive të barabarta.

## Mos e plotësoni — Vetëm për përdorim shkollor

Annual Income Conversion: Weekly x 52, Every 2 Weeks x 26, Twice a Month x 24, Monthly x 12

| Total Income | How often? Weekly | Bi-Weekly | 2x Month | Monthly | Yearly | Household Size | Categorical Eligibility | Eligibility: Free | Reduced | Denied | Date Denied | Reason for Denial or Withdrawal |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ○ | ○ | ○ | ○ | ○ | | ☐ | ○ | ○ | ○ | | |

Determining Official's Signature ____ Date *Mo./Day/Yr.* ____

Confirming Official's Signature ____ Date *Mo./Day/Yr.* ____
Required for Verification

Verifying Official's Signature ____ Date *Mo./Day/Yr.* ____
Required for Verification